

STATUTI I SHOQËRISË
“Albanopolis Hotel” shpk

Neni 1

Data e themelimit, Emri, Forma, themeluesit

1. Sot më datë (sipas nënshkrimit në fund të statusit), ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me *formë ligjore*: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, shoqeria do të ketë emrin “**Albanopolis Hotel**” **SH.P.K.**, (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
 1. **Z. Franc Jahelezi** lindur me datë 30.09.1983, lindur ne Bajram Curri, dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer Letërnjoftimi ID 029470222, lëshuar nga Ministria e Brëndshme.

Neni 2

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresë: Rr "Mine Peza – nr 23, Tiranë;

Neni 3

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Shoqëria ka si objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë në përputhje me legjisacionin e Shqipërisë, shoqëria ka për objekt të aktivitetit të saj Hoteli, dhe sherbime te tjera hoterie qe lidhen me akomodimin ne Hotel (furnizimin e sherbimit te akomodimit ne strukturat akomoduese). Blerje, marrje ambiente me qera dhe veprime te tjera qe lidhen me objektin e veprimtarise se Shoqerise. Struktura akomoduese hoteri, perfshire sherbimet e tjera te ofruara ne pakete te hotelerise si bar dhe restaurant.

Shoqëria mund të marrë pjesë në tenderët e thirrur nga organet publike ose private, drejtpërdrejt ose tërthorazi për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në këtë Statut;

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 1000 lekë, i ndarë në nje kuotë, i cili

zotërohet si më poshtë:

Z. Franc Jahelezi zotëron 1 kuotë me vlerë 1000 lekë, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Neni 6
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 7
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk

mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8
Mënyra e thirrjes

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë

Neni 9
Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 10 të Statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendor në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10
Marrja e vendimeve

Me përashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në paragrin e parë të nenit 9 të këtij statuti, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.


Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 11
Administrimi

Administrator i shoqërisë është:

- **Vesa Mulgeci**, e datëlindjes 27.09.2000, lindur në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Leternjoftim ID me numër 034190629 dhe me numër personal K05927072R emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtitje.



Asambleja e ortakëve emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë me shumicë të zakonshme. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët i ushtrojnë kompetencat bashkë ose veç e veç.

Neni 12 Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmes veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 13 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14 Bilanci i shoqërisë dhe dividentët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve vendos rrëth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarësë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne rastin e pikës b) Asambleja e Ortakëve merr vendim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 16

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvèçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Neni 17

Riorganizimi (bashkim, ndarja, shndërrimi)

Riorganizimi i shoqërisë (bashkim, ndarje, shndërrim) do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet që mund te lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 20

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me vullnetin e tij te lire nga ortakët themelues.

THEMELUES

Franc Jahelezi

*Franc Jahelezi
Pec*

Tiranë, më datë 06.02.2020